



FILLOI PUNIMET KONFERENCA DY DITORE E MËSIMDHËNËSVE TË GJUHËS GJERMANE NGA KOSOVA DHE SHQIPËRIA



Në gjimnazin “ Lojola” në Prizren ka filluar punimet dy ditore Konferenca Kombëtare e mësimitdhënësve të gjuhës gjermane. Pjesëmarrës në këtë konferencë janë mësimitdhënës të gjuhës gjermane nga shkolla të ndryshme nga Kosova dhe Shqipëria, profesor universitar si dhe akterë të ndryshëm, të cilët janë të lidhur dhe japin kontribut në mësimitin e gjuhës gjermane. Në hapje të kësaj konference ishte edhe ambasadorja e Gjermanisë në vendin tonë, Angelika Vits, e cila para ta pranishmëve tha se ndjehet e lumtur që në Kosovë dhe Shqipëri është numër i madh i atyre që e kuptojnë dhe flasin gjuhën gjermane. Prej se kam ardhur para 6 javëve në Kosovë, jam shumë e befatur me numrin jashtëzakonisht të qytetarëve të këtushëm që kanë njohuri për gjuhën gjermane. Njohja e gjuhës gjermane pa dyshim se krijon shumë mundësi që në të ardhmen kosovarët dhe shqiptarët të studiojnë në shtetin tonë e pse jo edhe të punojnë. Ne do të përkrahim të gjitha ato institucione të cilat mundësojnë përdorimin e metodave adekuata për mësimitin e gjuhës gjermane edhe në të ardhmen” theksoi ambasadorja Vits. Edhe kryetarja e shoqatës gjermano- shqiptare, Jonida Peza, e vlerësoi të rëndësishme këtë konferencë. “Kjo konferencë ka për qëllim që ta bëjë edhe më popullore gjuhën gjermane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me shoqata të tjera të mësuesve të gjermanishtes nga vende të tjera të zbatojë masa të përbashkëta mbështetëse. Konferenca e përvitshme e mësuesve të gjermanishtes, është event i rëndësishëm dhe i frekuentuar mes aktiviteteve të Shoqatës. Përmes referateve të gjermanistëve dhe didaktëve të njohur nga brenda dhe jashtë vendit si dhe përmes diskutimeve në ëorkshop-e dhe prezantimeve të shtëpive botuese pjesëmarrësit mund të marrin informacion dhe të shkëmbejnë përvojat e tyre. Në këtë konferencë shkencore mësuesit dhe mësueset e gjermanishtes kanë mundësinë të prezantojnë në formën e një referati të shkurtër dijet dhe analizat e tyre shkencore”, tha ajo. Kjo është një konferencë e cila mbahet për çdo vit në Shqipëri, ndërsa për herë të parë këtë vit do të mbahet edhe në Kosovë...